



Erasmus+

Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan

shpall këtë:

**Thirrje për aplikime për shkëmbim të stafit në
Universitetin “Celal Bayar” Manisa, Turqi**

Universiteti “Kadri Zeka” është pjesë e projektit KA107 ICM, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Manisas në Turqi.

Programi Erasmus + KA107 ose Shkëmbimi afatshkurtër i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimën e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit Manisa Celal Bayar, Manisa, Turqi dhe Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative të UKZ-së.

Kohëzgjatja e bursave:

- Staf akademik (në kohëzgjatje 5 ditë, + 2 ditë vajtje, ardhje)
- Staf administrativ (në kohëzgjatje 5 ditë, + 2 ditë vajtje, ardhje)

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluara nga projekti:

Shpenzimet e qëndrimit dhe 275 për udhëtim sipas Distance Calculator të Erasmus + (<https://erasmusplus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>).

Granti i udhëtimit do të paguhet gjatë mobilitetit.

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

APLIKIMI dhe PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafin janë:

Të jeni mësimdhënës ose punëtor i rregullt në UKZ

Dokumentet e nevojshme për aplikim.

- CV
- Lista e publikimeve për stafin akademik (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale);
- Certifikata e gjuhës angleze ose turke (Minimum B2);
- Letër mbështetëse nga stafi akademik i Universitetit të Manisas (i/e cila pajtohet për të bashkëpunuar gjatë qëndrimit tuaj një-javor në Manisa);
- Kontrata e punës me UKZ;
- Posedimi i certifikatave të Gjuhës Angleze, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht;

Përzgjedhja bëhet:

- Në bazë të fushës së përafërt të ligjërimit me fushat e ofruara nga Universiteti pritis 50% (vlen për stafin akademik)
- Gjuhë e huaj 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën e Arkivës (kopje fizike) nga data 07/04/2023 deri me 14/04/2023.
2. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
3. Të gjithë aplikantët duhet të jenë në gjendje të sigurojnë dëshmitë/certifikatën e gjuhës angleze.
4. Plani individual i mësimit duhet të mbushet, të nënshkruhet dhe të dorëzohet me dokumente të tjera të kërkuara.
5. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net
6. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh

Për cdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'D. Leka', is positioned below the printed name and title.